



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

**Nr. 2, datë 08.10.2013**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 2, DATË 29.05.2013,**  
**TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 8, 70/8 e 70/11, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të neneve 115\,a, 116, 117, 121 e 129, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe VKM nr. 877, datë 03.10.2013, “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, Këshilli Kombëtar i Territorit

**V E N D O S I:**

1. Pika 1, e vendimit nr. 2, datë 29.05.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për lejen zhvillimore komplekse për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë dhe godinës polifunkionale (3, 4, 6, 8 kate dhe 3 kate nën tokë), në kryqëzimin e rrugës “George W. Bush” dhe bulevardit “Zhan D’Ark”, Tiranë”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Të miratohet leja zhvillimore komplekse për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë në kryqëzimin e rrugës “George W. Bush” dhe bulevardit “Zhan D’Ark”, Tiranë”.

2. Konfirmimin e lejes zhvillimore komplekse për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë, sipas projektit të rishikuar në zbatim të pikës 1, në bashkëpunim me zhvilluesin “Komuniteti Mysliman Shqiptar”.
3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**KRYETARI**

**EDIRAMA**

**ZËVENDËS KRYETARE E K.K.T**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**

*Egjeimi*



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

*Adelina Greca*

